



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROÇEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 692/ Prot.

Tiranë, më 30/12/2013

Lënda : Dërgohen komente lidhur me projekt-ligjin "Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Drejtuar : Z. Nasip NAÇO
MINISTËR I DREJTËSISË

TIRANË

I nderuar zoti Ministër !

Në vijim të shkresës Tuaj me nr. 5825 prot, datë 02.12.2013, me anë të së cilës kërkohen mendime lidhur me projekt-ligjin "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", pasi u njohën me projektligjin, Ju parashtojme sa më poshtë disa rekomandime:

1. Në riformulimin që i është bërë parimeve kryesore që udhëheqin Kodin e Procedurave Administrative, konstatojmë se nuk gjen më pasqyrim parimi i barazisë. Rekomandojmë:

Riformulimin e nenit 5 të projektligjit ose shtimin e një neni të veçantë, ku të formulohet parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, si parime të rëndësishme që duhet të udhëheqin veprimtarinë e çdo organi publik apo subjekti privat që ushtron funksione publike. Shkaqet e mbrojtura nga diskriminimi duhet të jenë në harmoni me parashikimet e nenit 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

2. Në Titullin V, Kreu 4, Seksioni 2, janë parashikuar mjetet e kërkimit të provës. Në këtë kre, në nenin 59, pika 2, bëhet referim tek Kodi i Procedurës Civile lidhur me mjetet e provës dhe kërkimin e tyre, për aq sa është e mundur dhe nuk parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Kod.

Në këtë kre, por as në dispozita të tjera nuk ka parashikime lidhur me barrën e provës. Kodi i Procedurës Civile në nenin 12, përcakton se pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin që të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj. Ky përbën rregullin e përgjithshëm për barrën e provës, sipas të cilit detyrimi për të vërtetuar faktet e nevojshme për të provuar pretendimin është i palës që e pohon atë.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, personi që pretendon se ndaj tij nuk është respektuar parimi i trajtimit të barabartë e ka tepër të vështirë apo të pamundur t'i mbledhë provat dhe ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Për këtë arsye Bashkimi Europian ka integruar në legjislacionin antidiskriminim parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Në dhjetor të vitit 1997, Këshilli Europian ka miratuar Direktivën 97/80 për barrën e provës në çështjet e diskriminimit për shkak të gjinisë. Në këtë direktivë parashikohet:

“ 1. Shtetet Anëtare do të ndërmarrin masa të tilla sipas nevojës, në përputhje me sistemet e tyre kombëtare juridike, për t’u siguruar se, kur personat që konsiderojnë se u është bërë një e padrejtë për shkak të moszbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, sjellin përpara një gjykatë apo ndonjë autoriteti tjetër kompetent, fakte nga të cilat mund të supozohet se ka patur diskriminim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, atëherë do të jetë detyra e të paditurit të vërtetojë se nuk ka patur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë”

I njëjti formulim përdoret edhe në direktivat e mëvonshme në fushën e mosdiskriminimit, të cilat janë: Direktiva e Këshillit 2000/43/KE të 29 qershorit 2000 për *“Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”*, Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për *“Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”*, Direktiva e Këshillit 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për *“Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”*, Direktiva e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al


për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”.

Pra, nëse normalisht detyrimin për të provuar pretendimet duhet ta kishte paditësi/ankuesi, sipas legjislacionit të BE-së në çështjet e diskriminimit, në momentin që paditësi/ankuesi vërteton rastin *prima facie* -“në pamje të parë”, pra duhet të vërtetojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka ndodhur diskriminimi në mungesë të një shpjegimi të përshtatshëm, atëherë i kërkohet të paditurit/personit kundër të cilit bëhet ankesë, që të paraqesë prova se ai/ajo nuk e ka diskriminuar paditësin/ankuesin, duke rrëzuar prezumimin faktik se ka patur diskriminim.

Kodi i Procedurave Administrative është ligji bazë për procedurat që organet publike, por jo vetëm, duhet të respektojnë gjatë veprimtarisë së tyre. Shumica e nevojave të përditshme adresohen nga veprimtaria administrative, duke e bërë këtë Kod me rëndësi nga kënvështrimi i mbrojtjes nga diskriminimi.

Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, për pjesën e procesit administrativ të shqyrtimit të ankesave nga ana e Komisionerit, me përjashtim të procedurave që janë parashikuar në këtë ligj, parashikon zbatimin e normave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Në bazë të në ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi garantohej jo vetëm ndaj veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve publike, por shtrihet edhe ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të personave fizikë apo juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë. Kjo bën që subjekte të procesit administrativ që zhvillon Komisioneri për shqyrtimin e ankesave që i paraqiten, të jenë jo vetëm organet publike, por edhe subjektet private. Përveç kësaj, edhe subjektet e tjera si punëdhësit (publik ose privat), drejtuesit e institucionit arsimor (publik ose privat), në bazë të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” kanë detyrimin të marrin në shqyrtim ankesat për diskriminim që u paraqiten, duke respektuar normalisht procedurat e hetimit administrativ që përcakton Kodi i Procedurave Administrative, për sa kohë që ligji i posaçëm nuk ka parashikime të posaçme.

Në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire*, në lidhje me barrën e provës kërkohet që për rastet kur kërkesa e paraqitur para organeve publike, por jo vetëm (subjekte private në fushën e punësimit dhe arsimin), ka të bëjë me cënimin e parimit të barazisë, kërkohet që barra e provës të zhvendoset/shpërndahet.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Sa më sipër dhe me qëllim përafrimin e legjislacionit me *acquis communautaire* të BE-së dhe harmonizimin e legjislacionit të brendshëm propozojmë:

- Shtimin e një neni në Titullin V, Kreu 4, Seksioni 2, që të rregullojë barrën e provës në çështjet e diskriminimit, me përmbajtje si vijon:

“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka patur diskriminim, pala tjetër detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në përputhje me parashikimet e direktivave të BE-së e ka parashikuar zhvendosjen /shpërndarjen e barrës së provës në procedurat përpara gjykatës, kur kjo e fundit shqyrton një padi diskriminimi dhe konkretisht në nenin 36 pika 6 e ligjit.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al